

NË EMËR TE POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA RAHOVEC/Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ilir Rashkaj, me procesmbajtësin Xhemajli Shala, sekretar juridik i kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. K. nga fshati X., komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.1205/2015 të datës 29.02.2016, në shqyrtimin gjyqësor të datës 29.08.2018, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ismet Tofaj, të akuzuarit, si dhe përfaqësuesit të dëmtuarës L. M., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarit,

A. K., nga i ati I. dhe e ëma I., e vajzërisë B., i lindur me dt.... në fshatin X., komuna e Rahovecit, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, bujk, i martuar, i ati i katër (4) fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPPK-së,

REFUZOHET AKUZA

Sepse, me datë të pavërtetuar e gjerë me dt.09.01.2015, në lokalit të tij përkatësisht barnatoren “L. P” në fshatin X., komuna e Rahovecit, me qëllim që vetit ti sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm në mënyrë të paautorizuar ka shfrytëzuar energjinë elektrike në atë mënyrë që jashtë njehsorit elektrik me nr.73445469, përmes kabllor ka bërë lidhjen direkte në rrjetin elektrik, me çka ka penguar kështu regjistrimin e energjisë së shpenzuar elektrike, gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar të KEDS – Distrikti në Gjakovë, me rastin e kryerjes së kontrollës, me ç’rast të dëmtuarës KEDS – Divizioni i Rrjetit – Distrikti në Gjakovë i ka shkaktuar dëm material në shumën prej 2,215.12 Euro.

Këso dore, kishte për të kryer veprën penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

- Për shkak se prokurori i shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor është tërhequr nga akuza.

Shpenzimet e procedurës penale bijnë në llogari të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

E dëmtuara KEDS – Distrikti në Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë e ka parashtruar aktakuzën PP.nr.1205/2015 të datës 29.02.2016, ndaj të akuzuarit A. K. nga fshati X., komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Prokurori i Shtetit Ismet Tofaj, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: Bazuar në deklaratën e dëshmitarit D. Sh. të dhënë në shqyrtimin gjyqësor me datën 07.09.2018, se lokalin e ka në shfrytëzim në bazë të kontratës mbi qiranë të lidhur në mes të vëllait të tij dhe të akuzuarit si dhe në bazë të kontratës mbi qiranë e lokalit afarist të lidhur me 15.06.2012, në mes të akuzuarit dhe qiramarrësit H. S. Sh., në mungesë të provave tërhiqet nga ndjekja penale ndaj A. K. me faktin se ditën kritike lokali afarist ka qenë në shfrytëzim në bazë të kësaj kontrate nga qiramarrësi H. Sh..

Andaj, gjyqtari i vetëm gjykues duke pasur parasysh se prokurori i shtetit, është tërhequr nga aktakuza, PP.nr.1205/2015 e dt.29.02.2016, ndaj të akuzuarit A. K., gjatë shqyrtimit gjyqësor, në kuptim të nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPPK-së, mori aktgjykim refuzues në këtë çështje penale.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e bazoi në nenin 454 par.1 të KPPK-së.

Vendimi për kërkesën pasurore juridike është marrë bazuar në nenin 463 par.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA RAHOVEC
- Divizioni Penal -
P.nr.85/2016, me datë 29.09.2018

Sekr. juridik,
Xhemajli Shala

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Irir Rashkaj

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.